

## Relacion Teknik

Objekti:

**Ura auto Plan, Bashkia Pukë**

### *Të përgjithshme.*

Fshati Plan shtrihet në territorin e Njësisë Administrative Luf të Bashkisë Pukës. Ky fshat kufizohet me Qarretin në Veri dhe me Lufin në Jug. Ka resurse të mira për rritjen e prodhimeve bujqësore, si dhe në agrikulturë dhe në blegtori, këto janë favorizuar nga kushtet e mira klimatike, hidrologjike dhe tokat e përshtatshme.

Banorët e këtij komuniteti në të shumtën e rasteve nuk e kanë braktisur këtë fshat për shkak të favoreve që jep toka bujqësore dhe blegtorja, pamvarësisht kushteve jo të mira të infrastrukturës rrugore auto. Në këtë fshat ka fillësën përroi i Kçirës, dhe më poshtë saj përroi i Gomsiqes së Vogël, në këtë zonë mblidhen disa përroska përgjatë shtegtimit të tij nëpër luginën e Qarretit të madh (Plani), si përroi Jazit të Majt, përroi Gurrash, përroi i Rrahut, përroi i Arrës Nezirirt, përroi i Shas, përroi Marajt, përroi Shkallash, përroi i Zanave, etj., këta përrenj kalojnë në vëndin ku propozohet të ndërtohet aksi i urës auto tip “Beli”. Gjatë sezonit me reshje shiu shtrati i përroi bëhet i pakalueshëm për automjetet, si dhe për këmbësorët, duke e vështirësuar dhe duke e bërë të pamundur kapërcimin e tij. Rruga auto që kalon këtë përrua nuk ka urë auto, pasi një të tillë nuk e ka patur asnjëherë. Mungesa e kësaj ure e bën prioritet ndërtimin e saj.



**Fig. 1** Pamje e përroit në aksin e propozuar për ndërtimin e urës auto (një degë e përr. Gomsiqes)

## Gjendja aktuale.

Fshati Plan ka rrugën auto ekzistuese me shtresa çakulli në gjendje jo të keqe të tabanit të saj, e cila lidh këtë fshat me rrugën auto nacionale Pukë - Shkodër, në disa segmente ajo ka edhe vepra arti, si tombino apo ndonjë urë me hapsirë drite të vogël. Rruga bëhet e pakalueshme tek përroi i Kçirës në sezonin e reshjeve të shiut, pasi prurjet ujore të saj janë të rrëmbyeshme dhe shumë të mëdha, vetëm me pushimin e reshjeve dhe uljen e prurjeve lumore e cila mund të zgjasë disa ditë, me raste edhe me muaj atëherë mund të bëhet e kalueshme për banorët për plotësimin e nevojave të domosdoshme jetike.

Në aksin ku planifikohet të ndërtohet ura auto e re (tip Beli) e cila i korrespondon afërsisht edhe gjurmës ekzistuese të kalimit të përroit, terreni nuk ka skarpata anësore të brigjeve, pasi ajo ka një topografi të rrafshët me një thyerje të lehtë në shtratin e përroit. Kjo gjë e bën urën që përvec bazamenteve për mbështetjen e saj të ndërtohen edhe shpatullat (viadukte) lidhëse me urën në të dyja anët e saj.

## Masat inxhinierike.

Referuar mundësive financiare, fluksit të lëvizjes së automjeteve dhe domosdoshmërisë së ndërtimit të urës auto, është zgjedhur urë auto tip «BELI», ku në projekt janë parashikuar të mbulohen me fond vetëm punimet nën strukturore të urës, kurse për ndërtimin e pjesës mbi strukturore është gjetur mundësia e bashkëpunimit të Bashkisë Pukë me Ministrinë e Mbrojtjes për të siguruar konstruksion të gatshëm metalik që përdor ushtria për kalimin e përrënjëve në zonat malore. Konstruksioni metalik do të mbulojë një hapsirë drite 13.5 m (në total gjithë gjatësia e konstruksionit parashikohet 15m, kjo gjatësi është e domosdoshme në funksion të gjerësisë së shtrazit të lumit dhe prurjeve ujore që sjell kryesisht gjatë sezonit të vjeshtës dhe pranverës.

Në projekt është parashikuar :

1. **Punime nënstrukturore.** Ndërtimi i urës auto me një hapsirë drite 13.5 m, të inkastruar në brigje me dy pila beton arme, pilat do të ndërtohen mbi themelin (jastëkun e pilotave) me thellësi 1.5m nga kuota më e ulët e shtrazit të përroit në aksin e propozuar, ku kjo e fundit është inkastruar mbi 2 pilota beton arme Ø 800mm me thellësi 4m (sejcila). Ura duke patur vetëm një hapsirë drite do të ketë vetëm 2 pila mbajtëse.






Fig. 2 Planimetria e projektit te propozuar

2. **Punime mbistrukturore.** Është parashikuar vetëm shtresa e dërrasës me trashësi 5cm, mbi konstrukcionin e gatshëm metalik ku kjo e fundit do të sigurohet nga Ministria e Mbrojtjes.



**Fig. 3** Prerje gjatësore e urës auto të propozuar, sipas aksit tërthor të përroit.

3. **Punime shpatulla.** Rakordimi i urës me rrugën auto do të realizohet nëpërmjet shpatullave (mure mbajtëse - b/betoni C 7/10 me 25% gur dhe murë me gabiona), këto shpatulla do të bëjnë të mundur kanalizimin e rrjedhjes së lumit nëpër shtratin e tij të hapur, si dhe rakordimin e kuotës së urës në pjesën kaluese me të dyja anët e rrugës auto.



**Fig. 3** Prerje tërthore e shpatullave të urës, të cilat lidhin urën me rrugën auto ekzistuese.

*Në funksion të realizimit të tre pikave të mësipërme është llogaritur edhe kostoja e ndërtimit të urës auto, pamvarësisht mundësisë financiare, është e pamundur që të realizohet ky objekt në fazë të ndara, pasi ura duke qenë një strukturë e vetme në tërësinë sajë, ajo nuk mund të ndahet, aq më tepër që ajo ka vetëm 2 pila (këmbë).*

PUNOI:

ING. LAVDRIM BRUKA